	E përmbushur E papërmbushur
<b>Firma</b>	
<b>Vula e Autoritetit Kontraktor</b>	

**Shtojca 10**

[ *Shtojcë për t’u plotësuar nga Operatori Ekonomik* ]

**MBI DISPONIMIN E MAKINERIVE**

Operatori ekonomik: \_\_\_\_\_

**Deklaroj se zotëroj mjetet pajisjet teknike dhe asete të tjera fizike për të realizuar kontratën me objekt:** \_\_\_\_\_

Dokumenta Standarde të Tenderit  
**Rikonstruksioni i Magjistralit Kryesor dhe Rrjetit të Brendshëm të Ujësjellësit Qytetit Patos Loti II”.**

Në pronësi				
Lloji i Mjetit	Targa	Nr. Lejes qarkullimit	Nr. Shasisë	Të tjera
1				
2				
3				

Dhe

Me qera					
Lloji i Mjetit	Targa e mjetit	Nr. Lejes së qarkullimit të mjetit	Nr. Shasisë së mjetit	Nr. Kont së qerasë (noterisë)	Afati i kontratës së qerasë (Data e fillimit dhe mbarimit)
1					
2					
3					
4					

- shto/fshi rreshta të tjerë nëse nevojitet.

Ne autorizojmë autoritetin kontraktor të verifikojë informacionin e dhënë në këtë tabelë

**PERSONI I KONTAKTIT (për këtë ofertë)**

**Emri:**

**Adresa:**

**Nr. Telefonit:**

**Faks:**

**E-mail:**

**Nënshkrimi**

**Vula**

**Shtojca 11**

*(Shtojcë për t’u plotësuar nga Operatori Ekonomik)*

**DEKLARATË MBI KONTRATAT E LIDHURA DHE/ OSE NE PROCËS<sup>1</sup>**

Dokumenta Standarde të Tenderit

**Rikonstruksioni i Magjistralit Kryesor dhe Rrjetit të Brendshëm të Ujësjellësit Qytetit Patos Loti II”.**

Deklaratë e operatorit ekonomik pjesëmarrës në procedurën e prokurimit që do të zhvillohet në datë \_\_\_\_\_ nga Autoriteti Kontraktor \_\_\_\_\_ me objekt \_\_\_\_\_ me fond limit \_\_\_\_\_.

Unë i nënshkruari \_\_\_\_\_ me cilësinë \_\_\_\_\_ të operatorit ekonomik \_\_\_\_\_ deklaroj se kam në proçes dhe/ose jam shpallur fitues për kontratat e mëposhtme:

Nr.	Autoriteti kontraktor	Objekti i procedurës së prokurimit/kontratës	Vlera e shpallur fituese

**Data e dorëzimit të deklaratës** \_\_\_\_\_

**Përfaqësuesi i ofertuesit**

**Nënshkrimi**

**Vula**

**Shënim:** Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomikë, secili prej anëtarëve të bashkimit duhet të plotësojë këtë deklaratë.

**Shtojca 12**

[ *Shtojcë për t’u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor* ]

**1. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PRANIMIT/KUALIFIKIMIT**

Ofertuesi duhet të deklarojë se:

a) Është i regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit dhe ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit. Në rastin kur ofertuesi është një organizatë jofitimprurëse, duhet të deklarojë se është i regjistruar si person juridik, sipas Ligjit Nr.8788, datë 07.05.2001 “Për Organizatat jo Fitimprurëse”.



**Rikonstruksioni i Magjistralit Kryesor dhe Rrjetit të Brendshëm të Ujësjellësit Qytetit Patos Loti II”.**

- b) nuk është në proces falimentimi, (statusi aktiv)
- c) nuk është dënuar për shkelje penale, në përputhje me Nenin 45/1 të LPP,
- ç) nuk është dënuar me vendim të gjykatës së formës së prerë, për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale.
- d) ka paguar të gjitha detyrimet për pagimin e tatimeve e të kontributeve të sigurimeve shoqërore, sipas legjislacionit në fuqi.

Edhe Ofertuesi i huaj duhet të deklarojë se i plotëson të gjitha kërkesat e renditura më sipër nëpërmjet paraqitjes së një vetëdeklarate me shkrim.

Nëse gjuha e përdorur në procedurë është gjuha shqipe, atëherë dokumentat në gjuhë të huaj duhet të shoqërohen me një përkthim të noterizuar në gjuhën shqipe.

Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vetëdeklaratën e lartpërmendur.

**Kriteret e Përgjithshme për Pranim, nuk duhet të ndryshohen nga autoritetet kontraktore.**

**Këto kritere duhet të plotësohen me dorëzimin e vetëdeklaratës me shkrim të subjektit, në ditën e hapjes së ofertës, sipas Shtojcës 8.**

**Në çdo rast, autoriteti kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër.**

**Veç kësaj, nëse oferta dorëzohet nga një bashkim operatorësh ekonomikë, duhet të dorëzohen:**

- a. Marrëveshja e noterizuar sipas së cilës bashkimi i operatorëve ekonomikë është krijuar zyrtarisht;
- b. Prokura e posaçme.

**\*\*\*Shënim: Për kryerjen e verifikimeve përkatëse të gjendjes gjyqësore të personave të deklaruar në shtojcën 4, lutemi të plotësoni të dhënat për personin/at në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtuesit ose mbikëqyrësit, aksionerit ose ortakut, ose ka kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik, si më poshtë:**

**Emër, Atësi, Mëmësi, Mbiemër, Ditëlindje**

## **2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT**

1. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

- a. *Përshkrimin e Ofertës, sipas Shtojcës 1;*
- b. *Deklaratë për paraqitje oferte të pavarur, sipas Shtojcës 1/1;*
- c. *Sigurim oferte, (nëse është e zbatueshme) sipas Shtojcës 3;*
- ç. *Deklaratë mbi përmbushjen e Specifikimeve teknike, sipas Shtojcës 5;*
- d. *Deklaratë mbi Konfliktin e Interesit sipas Shtojcës 7;*
- dh. *Deklaratë mbi garantimin e zbatueshmërisë së dispozitave ligjore në marrëdhëniet e punës Shtojcës 8/1;*
- e. *Formular vlerësimi sipas Shtojcës 9;*
- f. *Deklaratë mbi disponueshmërinë e mjeteve sipas Shtojcës 10;*
- g. *Deklarate mbi kontratat e lidhura apo ne proces, sipas Shtojcës 11;*
- gj. *Vërtetimin që konfirmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike të kontratave të energjisë që ka operatori ekonomik që është i regjistruar në Shqipëri, te leshuar jo me heret se 30 dite nga data e hapjes së ofertes*

Dokumenta Standarde të Tenderit

**Rikonstruksioni i Magjistralit Kryesor dhe Rrjetit të Brendshëm të Ujësjellësit Qytetit Patos Loti II”.**

*h. Grafikon e punimeve.*

**2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:**

**2.1. Per kapacitetin ligjor/profesional i operatorëve ekonomikë:**

Sipas kriterëve të përgjithshme për kualifikim

**2.2. Për kapacitetin ekonomik dhe financiar:**

a. Vërtetim lëshuar për shlyerjen e taksave dhe tarifave Vendore të parashikuara nga Pushteti Vendor për vitin 2020, kudo ku operatori ushtron aktivitet, sipas regjistrimit në QKB.

*(Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vërtetimin lëshuar nga Bashkia në të cilën është regjistruar sipas QKB-se).*

b. Xhiroja mesatare vjetore për vitin **2017, 2018 dhe 2019** duhet të ketë një vlerë jo më të ulët se **304,470,697 (treqind e katër milion e katërqind e shtatëdhjetë mijë e gjashtëqind e nëntëdhjetë e shtatë) lekë (50 % e fondit limit).**

c. Kopje të certifikuar të bilancit të viteve **2017, 2018 dhe 2019** të paraqitura në autoritetin përkatës Drejtoria e Tatimeve, të konfirmuara nga ky autoritet si dhe nga një Ekspert Kontabël i Autorizuar.

**2.3 Per kapacitetin teknik:**

**2.3.1- Përvojë e suksesshme në realizimin e të paktën:**

a. Punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë prej jo më pak se **304,470,697 (treqind e katër milion e katërqind e shtatëdhjetë mijë e gjashtëqind e nëntëdhjetë e shtatë) lekë** dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit nga data e dorëzimit të ofertës.

b. Punë të ngjashme deri në një kufi ku vlera monetare totale e punëve të kryera e marrë së bashku gjatë tre viteve të fundit nga data e dorëzimit të ofertës të paktën një vlerë prej **1,217,882,790 (një miliard e dyqind e shtatëmbëdhjetë milion e tetëqind e tetëdhjetë e dy mijë e shtatëqind e nëntëdhjetë) lekë**

**(Plotësimi i njërit prej 2 kushteve të sipërpërmendura e bën Ofertën të kualifikueshme.**

**2.3.1/a Për kontrata të realizuara me autoritete publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:**

- a. Formularin e vleresimit
- b. Kontratën/Kontratat
- c. Situacionin përfundimtar;
- d. Aktin e kolaudimit;
- e. Çertifikaten/Çertifikatat e marrjes në dorëzim.
- f. Faturat tatimore përkatëse për çdo situacion të miratuara nga investitori.

**Per kontratat e realizuara si Bashkim Operatorësh duhet të paraqitet si vijon:**

- a. Kontrata e Bashkim Operatorësh deklaruar në fazën e tenderimit.
- b. Prokura e posaçme e Bashkim Operatorësh deklaruar në fazën e tenderimit.

Dokumenta Standarde të Tenderit

**Rikonstruksioni i Magjistralit Kryesor dhe Rrjetit të Brendshëm të Ujësjellësit Qytetit Patos Loti II”.**

*Ne rast se kontrata e paraqitur eshte realizuar si Nenkontraktor duhet te paraqitet si vijon :*

- a.Kontrata baze ndermjet kontraktorit dhe autoritetit kontraktor
- b.Miratimi zyrtar si nenkontraktor nga ana e autoritetit kontraktor

*2.3.1/b Për kontrata të realizuara me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:*

- a.Formularin e vleresimit
- b.Kontrate/Kontratat.
- c.Leja e ndertimit
- d.Situacionin përfundimtar;
- e.Akt kolaudimi objekti;
- f.Çertifikaten e marrjes ne dorezim te objektit;
- g.Fatura tatimore per cdo situacion punimesh te miratuara nga investitori.

*Pika 2.3.1/a plotësohet nga anëtari i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontratat e ngjashme në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.*

*Pika 2.3.1/b duhet të plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre ne bashkim.*

**1.**Operatoret ekonomike duhet te deshmojne se disponojne licënsa profesionale per zbatim punimesh ne ndertim si dhe ne licënsa disponojne kategorite e nevojshme per zbatimin ekontrates. Per kete duhet te paraqesin licënsen perkatesete shoqerise, bazuar ne formatin e miratuar me Vendim të Keshillit te Ministrave Nr. 42 date 16.01.2008; *Per miratimin erregullores per kriteret dhe Procedurat e dhenies se licensave profesionale te zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit te Subjekteve juridike qe ushtrojne veprimtari ndertimi”, I ndryshuar.*

Liçenca e shoqërisë e vlefshme për kategoritë e mëposhtme:

**NP- 1 ; Punime gërmimi në tokë.**

**“Kategoria B”**

*Per punimet e germimit, nivelimit dhe sistemimit qe shoqerojne shtrimin e linjave te ujesjellesit, ndertimin e depove grumbulluese,godinave te puseve, stacionet e pompave, ankerat etj*

**NP-2: Ndërtime civile dhe industriale.**

**“Kategoria C**

”

**NP-4 Rrugë autostrada, ura, mbikalime hekurudha, linja tramvaji,metro, hekurudhë me kavo dhe pista aeroportuale.**

**“Kategoria A”**

**NP- 7; Ujësjellësa ,gazsjellësa, vajsjellësa, vepra kullimi e vaditje**

**“Kategoria F”**

*Përfshin në mënyrë të thjeshtuar veprat e kaptazhit të ujit, ujësjellësit, kullat e ujit, stacionet e pompimit, depozitat në tokë ose të ngritura, rrjetin shpërndarës deri tek përdoruesi, furnizimi dhe vendosja në vepër e tubacioneve etj.*

**N.P-9: Punime mbrojtje lumore, sisteme hidraulike dhe bonifikime.**

**“Kategoria C”**

*Konsiderohen ndërtime, mirëmbajtje ose ristrukturime me ndërhyrje të sakta ose në rrjet, sido që të jenë*

**Rikonstruksioni i Magjistralit Kryesor dhe Rrjetit të Brendshëm të Ujësjellësit Qytetit Patos Loti II”.**

*realizuar, të nevojshëm për sistemimin e rrjedhjes së ujërave natyrale ose artificiale, si edhe për mbrojtjen e territorit nga këto ujëra, të kompletuara me punimet lidhëse të nevojshme.*

*Përfshin në mënyrë të thjeshtuar kanale lundruese, grykëderdhjet e lumenjve, konsolidimin e strukturave të anëve të lumenjve dhe përrenjve, argjinatura të llojeve të ndryshme, sistemimin dhe vendosjen e regjimit hidraulik të ujërave sipërfaqësore të veprave të diafragmave të argjinaturave dhe qëndrueshmërisë së shpateve.*

**NP-11; Ndërtime për nënstacionet, kabinat e transformatorëve, linja të TN e të mesëm dhe shpërndarja e energjisë. “Kategoria C”**

*Përfshin në mënyrë të thjeshtuar furnizimin me energji elektrike në TM të stacioneve të pompimit, f.v të linjave ajrore kablllore, sistemit të ndricimit, sistem të rrufepritesve dhe tokezimit etj.*

**NP -12; Punime të inxhinjerisë së mjedisit “Kategoria B”**

*Perfshin teresine e punimeve të ndertimit të veprave dhe linjave të ujesjellesit të shpërndara në territor me ndikim të drejtperdrejte në mjedis dhe procesin e riaftesimit të terrenit pas nderhyrjeve të realizuara për eliminimin e prishjes së ekuilibrave ekologjik dhe hidrologjik.*

**NS-1 ; Punime për prishjen e ndërtimeve “Kategoria A”**

Perfshin prishjen e strukturave betonarme dhe prishjet në pergjithësi që pengojnë implementimin e projektit në fjalë, përfshirë edhe grumbullimin e mbeturinave dhe transportin e tyre.

**NS-16 : Ndertimi i impianteve të ujit të pijshëm dhe pastrimit të tij “Kategoria B”**

**NS- 18 B; Punime topogjeozike “Kategoria B”**

**NS -20 B; Shpime gjeologo-inxhinjerike, puse e shpime për ujë “Kategoria B”**

Shoqëritë e huaja duhet të kenë kryer ekuivalentimin ( njësimin ) e licensave profesionale që disponojnë të lëshuara nga vendi i origjinës, pranë Ministrisë së Infrastrukturas dhe Energjisë, Republika e Shqipërisë, sic përcaktohet në ”Rregullorja për kriteret dhe procedurat e dhënies së licensave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndertimi, e miratuar me VKM Nr.42, datë 16.01.2008”

2. Për të provuar se ka përvojën e duhur, Operatori Ekonomik duhet të dëshmojë se ka të punësuar mesatarisht të paktën **150 (njëqind e pesëdhjetë)** punonjës, për periudhën (Janar 2020 - Qershor 2020), llogaritur mbi bazën e kohës së plotë të punës, të dëshmuar me;

- Vërtetim të lëshuar nga administrata tatimore për periudhën e kërkuar
- Formularët E-SIG 025 të konfirmuara nga organet përkatëse me nënshkrim elektronik

Numri i punonjësve është përcaktuar bazuar në preventivin dhe orët e punës dhe shpërndarjen gjeografike të punimeve që duhet për të përmbushur kontratën. Numri i punonjësve dhe qëndrueshmëria e tyre në punë me kohështrirje tregon besueshmëri për autoritetin.

2.1 Operatori duhet të dëshmojë se ka pjesë të stafit teknik që do të angazhohet për realizimin e punimeve stafin e mëposhtëm;

a. Operatori ekonomik duhet të ketë të punësuar si drejtues teknik stafin inxhinierik të mëposhtëm:

Inxhinier Ndërtimi

2 (dy)

**Rikonstruksioni i Magjistralit Kryesor dhe Rrjetit të Brendshëm të Ujësjellësit Qytetit Patos Loti II”.**

Inxhinier Hidroteknik	2 (dy)
Inxhinier Gjeolog	2 (dy)
Inxhinier Mekanik	2 (dy)
Inxhinjer Elektrik	1 (një)
Inxhinjer Mjedisi	1 (një)
Inxhinier Gjeodet	2 (dy)
Inxhinier Gjeoteknik	1 (nje)

Secili prej pjestarëve të stafit teknik të mësipërm duhet jetë ne listëpagesa për periudhën (Janar 2020 - Qershor 2020), dhe në licensën e shoqërisë.

Për secilin prej pjesëtareve të stafit duhet të paraqitet:

- Kontratë noteriale pune
- Diploma
- CV

**b. Operatori ekonomik duhet të ketë në stafin teknik për periudhën Janar 2020-Qershor 2020 stafin si më poshtë:**

Inxhinier Ndërtimi	2 (dy)
Inxhinier Ndërtimi profili transport	1 (një)
Inxhinier Elektrik	1 (një)
Inxhinjer Mjedisi	1 (një)
Inxhinier Gjeolog	1 (një)
Inxhinier Mekanik	1(një)
Inxhinier Gjeodet	1(një)
Arkitekt Peisazhi	1 (një)

Për secilin prej pjesëtareve të stafit duhet të paraqitet:

- Kontratë noteriale pune
- Diploma
- CV

**Punonjësit e kërkuar në pikën 2.1/a dhe b duhen plotësuar në mënyrë kumulative.**

c. Operatori ekonomik duhet te disponojë në stafin e tij punonjës të certifikuar (me dëshmi profesionale, në përputhje me zërat e punimeve në preventiv si më poshtë:

- Teknik ndërtimi 1 (një)
- Teknik topograf 1 (një)
- Specialist ndertimi (hidroizolues) 1 (një)
- Hidraulik 4 (katër)
- Mekanik 4 (katër)
- Saldator me deshmi (tubo celiku) 4 (katër)
- Saldator (Tubo HDPE) 4 (katër)
- Hekurkthyes 4 (katër)
- Elektracist 3 (tre)

**Rikonstruksioni i Magjistratit Kryesor dhe Rrjetit të Brendshëm të Ujësjellësit Qytetit Patos Loti II”.**

- Pompist 1 (një)
- Karpentier 4 (katër)
- Specialist të pajisur me leje përdorimi të enëve nën presion 3 (tre)
- Punonjës të specializuar për punimet në lartësi 4 (katër)
- Manovratorë mjetesh të rënda (Automakinist) - 5 (pesë) punonjës, pajisur me dëshmi aftësie profesionale.
- Manovratorë mjetesh të rënda (Eskavatorist ose Buldozierist) -10 (dhjetë) punonjës, pajisur me dëshmi aftësie profesionale.
- Shofere – 2 (dy) punonjës të pajisur me leje drejtimi dhe certifikatë për transportin e lëndëve të rrezikshme (ADR)
- Shoferë - 10 (dhjete) punonjës te pajisur me leje drejtimi dhe deshmi aftesie profesionale (CAP).

*Për punonjësit e sipërpërmendur të paraqiten dëshmitë përkatëse të kualifikimit profesional sipas kërkesave të mesiperme, kontratat e punës të vlefshme dhe të figurojnë në list –pagesat për periudhën (Janar 2020 - Qershor 2020)*

- d. *Operatori ekonomik duhet të ketë në listëpagesat e shoqërisë për periudhën (Janar 2020 - Qershor 2020) si pjesë e stafit teknik 1 (një) punonjës të pajisur me certifikatë "Ekspert për ndihmën e parë dhe ndërhyrjen ndaj emergjencave" e cila të jetë e lëshuar nga Kryqi i Kuq, shoqëri të akredituara ose organizma ndërkombëtare akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë.*
- e. Operatori ekonomik duhet të ketë në **staf 1 (një) punonjës** që disponon certifikatë si "Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë në përputhje me klauzolat e ligjit Nr. 10327, datë 18/02/2010 "Për sigurinë dhe shëndetin në punë" dhe V.K.M nr. 312, datë 05.05.2010 " Për miratimin e rregullores "Për sigurinë në kantier".
- f. **1 (nje) ekspert** për hartimin e raporteve të VNM-së për të kryer auditimin mjedisor, për hartimin e ekspertizave për problemet mjedisore dhe të thirret si ekspert për të vlerësuar një raport VNM apo rezultatet e auditimit, të shoqëruar me certifikatën e lëshuar nga autoriteti kompetent në bazë të VKM –së nr. 122, datë 17.02.2011, i ndryshuar.

*-Për punonjësit e mësipërm (në pikat ,d,e,f) të paraqitet kontratë noteriale pune, certifikata e kualifikimi dhe të figurojnë në listëpagesat e shoqërisë për periudhën Janar 2020- Qershor 2020.*

- 3.Operatori ekonomik duhet të jetë e pajisur me licensat e lëshuara nga QKB si me poshtë:
- a. Licensa për mbrojtjen nga zjarri, kodi 1.2 A
  - b. Licencë për veprimtarinë e ekspertizës lidhur me ndikimin në mjedis dhe auditim mjedisor kodi III.2.A (1+2)
  - c. Liçense për grumbullim, transportim dhe riciklimin e mbetjeve jo të rrezikshme ( mbetje inerte), kodi III .2.B

**Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomik, licencat e mësipërme kërkohen në përputhje**

Dokumenta Standarde të Tenderit  
**Rikonstruksioni i Magjistralit Kryesor dhe Rrjetit të Brendshëm të Ujësjellësit Qytetit Patos Loti II”.**

**me punët e kryera nga secili.**

**4.Numri dhe lloji i makinerive, pajisjeve në pronësi / qera: Dëshmi për mjetet e pajisjet teknike që ka në dispozicion apo që mund ti vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën. Mjetet dhe numri i tyre është përcaktuar bazuar në grafikun e punimeve, preventivin dhe oret e punës që duhet për të përmbushur kontratën.**

Nr	Emri i mjetit	Njesi	Sasi	Statusi
1	Koketerheqes + rimorkio veteshkarkuese me kapacitet mbi 20 ton	Copë	4	Në pronësi ose me qera
2	Koketerheqes + gjysemrimorkio me gjatesi jo me pak se 12 m.	Copë	4	Në pronësi ose me qera
3	Rimorkiator me kapacitet mbajtes min 20 ton	Copë	2	Në pronësi ose me qera
4	Kamionçina (deri 3.5 ton)	Copë	6	Në pronësi ose me qera
5	Autovinc me kapacitet ngrites mbi 20 ton	Copë	2	Në pronësi ose me qera
6	Autobetoniere	Copë	2	Në pronësi ose me qera
7	Autopompe betoni me lartesi pompimi jo me pak se 25 m	Copë	2	Në pronësi ose me qera
8	Autobot nafte	Copë	1	Në pronësi ose me qera
9	Autobot Uji	Cope	1	Në pronësi ose me qera
10	Fadrome me goma	Copë	1	Në pronësi ose me qera
11	Mini fadrome (bobcat)	Copë	1	Në pronësi ose me qera
12	Eskavator me goma	Copë	1	Në pronësi ose me qera
13	Greider	Copë	1	Në pronësi ose me qera
14	Eskavator me zinxhir	Copë	6	Në pronësi ose me qera
15	Eskavator krahegjate min 18 m	Copë	2	Në pronësi ose me qera
16	Minieskavator	Copë	3	Në pronësi ose me qera
17	Buldozer me fuqi mbi 100 kë dhe peshe jo me pak se 25 T	Copë	2	Në pronësi ose me qera

Dokumenta Standarde të Tenderit

**Rikonstruksioni i Magjistralit Kryesor dhe Rrjetit të Brendshëm të Ujësjellësit Qytetit Patos Loti II”.**

18	Aparate saldimi tubash	Copë	2	Në pronësi ose me qera
19	Aparate saldimi me elektrofuzion	Copë	2	Në pronësi ose me qera
20	Motopompe	Copë	2	Në pronësi ose me qera
21	Pompe stacionare	Copë	1	Në pronësi ose me qera
22	Motosaldatrice	Copë	3	Në pronësi ose me qera
23	GPS	Copë	2	Në pronësi ose me qera
24	Instrument Gjeodezik (Total station)	Copë	1	Në pronësi ose me qera
25	Nivele dixhitale te saktësisë së lartë	Copë	1	Në pronësi ose me qera
26	Aparature elektronike për kontrollin e preionit, pompe presioni për testimë	Copë	1	Në pronësi ose me qera
27	Kompaktor ngjeshës	Copë	2	Në pronësi ose me qera
28	Sistem ëellpoint/ ekuivalent për heqje ujërash	Copë	1	Në pronësi ose me qera
29	Sharre për prerje asfalti	Copë	2	Në pronësi ose me qera
30	Aparat saldimi tubacionesh HDPE, PVC	Copë	2	Në pronësi ose me qera
31	Kompresor ajri	Copë	1	Në pronësi ose me qera
32	Autobitumatrice	Copë	1	Në pronësi ose me qera
33	Rrul ngjeshës me peshe operative jo më pak se 18 ton.	Copë	2	Në pronësi ose me qera
34	Rrul vibrues hekur-hekur mbi 9 ton	Copë	1	Në pronësi ose me qera
35	Rrul vibrues hekur- hekur asfalti mbi 4 ton	Copë	1	Në pronësi ose me qera
36	Rrul vibrues hekur- gome asfalti mbi 8 ton	Copë	1	Në pronësi ose me qera
37	Freze asfalti	Cope	1	Në pronësi ose me qera
38	Asfaltoshtruese	Copë	1	Në pronësi ose me qera
39	Sond shpimi me peshe jo më pak se 30 T, me diametër 1 m dhe thellesi jo më pak se 60 m.	Copë	2	Në pronësi ose me qera
40	Nyje inerte e pajisur leje mjedisore	Copë	1	Në pronësi ose me qera ose kontratë furnizimi
41	Fabrike asfalti e pajisur me leje mjedisore	Copë	1	Në pronësi ose me qera ose kontratë furnizimi



**Rikonstruksioni i Magjistralit Kryesor dhe Rrjetit të Brendshëm të Ujësjellësit Qytetit Patos Loti II”.**

42	Fabrike betoni e pajisur me leje mjedisore	Copë	1	Në pronësi ose me qera ose kontrate furnizimi
43	Cekic vibrues (fuqi vibrimi min. 150 kë, force terheqese min 150 Kn, Force shtytese min 600 Kn.	Copë	1	Në pronësi ose me qera
44	Makineri (gershere) per nxjerje kolonash dhe profile metalike/palankola	Copë	1	Në pronësi ose me qera
45	Profile metalike (palankola) me gjatesi 8-10 m	Ton	10	Në pronësi ose me qera

**Të paraqiten mjete dhe pajisje të mbrojtjes në punë të punëtorëve, personelit si më poshtë:**

- Kokore minimumi 100 copë
- Jelekë minimumi 100 copë
- Prozhektorë ndriçimi natën minimumi 5 (pesë) copë
- Komplet i ndihmës së shpejtë minimumi 5 (pesë) copë
- Tabela paralajmëruese për sigurinë në objekt minimumi 30 (Tridhjetë) copë
- Kontenier per zyra dhe magazina 4 (kater) copë

**Eshte e mjaftueshme paraqitja e deklaratës sipas shtojcës nr. 10 dhe dokumentacioni si më poshtë:**

- a) Për mjetet me goma që shënohen në regjistra publike (nga pika 1-12) në listën e makineriv duhet të paraqitet dokumenti që verteton regjistrimin e mjetit ( të vlefshme), certifikatë e kontrollit teknik, siguracionin e mjetit (të vlefshme) certifikaten për transport mallrash dhe fotot përkatëse për secilin mjet.
- b) Për mjetet e siguruara me qera, perveç dokumentave që kërkohen më sipër duhet të paraqitet dhe certifikata për transport mallrash për të tretë dhe me qera brenda vendit, fotot përkatëse për secilin mjet dhe kontrata noteriale përkatëse të qerases/furnizimit, e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës objekt i këtij prokurimi.
- c) Për mjetet dhe pajisjet që nuk shënohen në regjistrat publike duhet të paraqiten dokumentat që vërtetojnë pronësinë e tyre apo marrjen me qera të tij.
- d) Për fabriken e asfaltit, impiantin e betonit dhe nyjen inerte nëse janë në pronësi duhet te paraqiten kontrata e blerjes apo cdoganimit, fotot dhe fatura tatimore përkatëse, leja mjedisore e lëshuar nga QKL. Nëse është marrë me qera, krahas dokumentacionit të meëipërm duhet të paraqitet edhe kontrata noteriale e qerasë. Operatori ekonomik për fabriken e asfaltit dhe betonit mund të paraqesë edhe kontrata të vlefshme furnizimi me operatorë ekonomikë. Në këtë rast duhet të paraqesë kontraten noteriale të furnizimit dhe dokumentacionin që vërteton ekzistencën e pronesisë së impianteve.

*Operatori ekonomik ofertues duhet të deklarojë që të gjitha mjetet dhe pajisjet e përshkruara më sipër do të jenë të angazhuara vetëm në këtë kontrate. Mjetet te cilat rezultojne të angazhuara në kontrata të tjera afati i zbatimit të të cilave shtrihet përgjatë afatit të kontratës*

Dokumenta Standarde të Tenderit

**Rikonstruksioni i Magjistralit Kryesor dhe Rrjetit të Brendshëm të Ujësjellësit Qytetit Patos Loti II”.**

*objekt prokurimi janë shkak skualifikimi.*

***Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën të verifikojë vërtetësinë e deklaratës. Në rast deklarimi të rreme do të veprohet në përputhje me nenin 13, pika 3, germa “a” të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006, I ndryshuar, “Për prokurimin publik”***

5.Operatori Ekonomik duhet të disponojë dhe paraqesë certifikatat të vlefshme:

- ISO 9001- 2015 (*Sistemi i Menaxhimit të Cilësisë*) ose ekuivalente ( e vlefshme)
- ISO 14001- 2015 (*Sistemi i Menaxhimit Mjedisor*)ose ekuivalente ( e vlefshme)
- OHSAS 18001- 2007/2013 ose ISO 45001-2018 (*Sistemi i Menaxhimit dhe Sigurisë në Punë*)ose ekuivalente ( e vlefshme)
- ISO 39001-2012 (*Sistemi i Menaxhimit të Sigurisë së Trafikut Rrugore*)ose ekuivalente(e vlefshme)
- ISO PAS 99:2012 (*Per sistemin e integruar të menaxhimit*)ose ekuivalente ( e vlefshme)
- ISO 3834-2:2006 (*Kerkesat e cilesise per saldim me shkrirje te materialeve metalike*)ose ekuivalente ( e vlefshme)
- ISO 50001: 2011 (*Për sistemin e menaxhimit të energjisë*) ose ekuivalente ( e vlefshme)

Te gjitha certifikata e mesiperme duhet te jene te lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

*(Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë përkatësisht Çertifikatën ISO sipas zërave të punimeve që do të marrë përsipër të realizojë sipas akt marrëveshjes).*

6.Operatoret e huaj ekonomik duhet të paraqesin të gjithë dokumentacionin e tyre në gjuhën shqipe(si gjuhe e ofertës), të bëjnë noterizimet përkatëse si dhe të jenë të certifikuara “Apostile”. Për vendet që nuk kanë ratifikuar Konventen e Hagës datë 5 tetor 1961, “Për heqjen e kërkesës për legalizim diplomatik e konsullor të dokumentave zyrtare të huaja”, duhet të bëhen legalizimet në ambasadat, konsullatat ose zyrat respektive nga vendi i origjinës.

7.Kantidatat/ ofertuesit duhet të përmbushin kërkesat ligjore të parashikuara në nenin 45 të Ligjit nr. 9643 date 20.11.2006 “Per prokurimin publik” i ndryshuar. Në rastin e bashkimit të operatoreve ekonomik, kantidatat/ ofertuesit duhet të përmbahen VKM-se nr.914 date 29.12.2014 “Per miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

8.Nese oferta dorezohet nga nje bashkim operatorësh ekonomik, duhet të dorëzohen marrëveshja e noterizuar sipas së cilës bashkimi i operatorëve ekonomik është krijuar zyrtarisht dhe Prokura e Posacme. Çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë dokumentat e kërkuara, në përpjestim dhe përputhje me punët e marra përsipër sipas marrëveshjes së bashkëpunimit.

Të gjithë dokumentat duhet të jenë origjinalë ose kopje të noterizuara të tyre. Rastet e mosdorëzimit të një dokumenti, ose të dokumentave të rreme e të pasakta, konsiderohen si kushte për skualifikim.

### **Shtojca 13**

*(Shtojcë për t’u plotësuar nga autoriteti kontraktor)*

#### **PROJEKTI I ZBATIMIT DHE SPECIFIKIMET TEKNIKE**

**Përshkrimi i të dhënave teknike të punëve objekt prokurimi** të përshkruara sa më saktë dhe në mënyrë të plotë, duke krijuar kushte për konkurrim të paanshëm e të hapur ndërmjet të gjithë kandidatëve e ofertuesve. Kur është e mundur, specifikimet teknike duhet të përcaktohen në mënyrë të tillë që të kuptohen nga personat me aftësi të kufizuara.

#### **KUJDES**

Specifikimet teknike nuk duhet të kenë asnjë kërkesë apo referencë të ndonjë markë apo emër i veçantë, patentë, vizatim ose tip, origjinë specifike, prodhues ose sipërmarrës shërbimi, përveç rasteve kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme, e përshkrimit të kërkesave, me kusht që fjalët “ose ekuivalent” të përfshihen detyrimisht në këto specifikime.

Skicimet, Planimetritë e Objektivit etj:

Specifikimet Teknike të Materialeve:

Grafiku i Punimeve:**24 muaj nga nënshkrimi i kontrates.**

Përshkrimi i kërkesave të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to:

Dokumenta Standarde të Tenderit  
**Rikonstrukcioni i Magjistralit Kryesor dhe Rrjetit të Brendshëm të Ujësjellësit Qytetit Patos  
Loti II”.**

**Shtojca 14**

*(Shtojcë për t’u plotësuar nga autoriteti kontraktor)*

Dokumenta Standarde të Tenderit  
**Rikonstrukcioni i Magjistralit Kryesor dhe Rrjetit të Brendshëm të Ujësjellësit Qytetit Patos Loti II”.**

**Shtojca 15**

[ Shtojcë për t’u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

**NJOFTIM STANDART PËR OFERTUESIN E SKUALIFIKUAR<sup>1</sup>**

[Vendi dhe data]

[Emri dhe adresa e autoritetit kontraktor]

[Adresa e ofertuesit]

I/E Nderuar Z. /Zj. <emri i kontaktit>

Ju falenderoj për pjesëmarrjen në procedurën e lartpërmendur të prokurimit publik. Procedura e kryer në përputhje me Ligjin nr. 9643 datë 20.11.2006 Për Prokurimin Publik.

Oferta juaj u vlerësua me kujdes sipas kushteve dhe kërkesave të përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e ofertës. Me keqardhje ju informoj se u s’kualifikuat, sepse oferta e dorëzuar nga ju u refuzua për shkak të arsyes (-ve) së/të mëposhtme:

---

---

---

---

Nëse mendoni se Autoriteti Kontraktor ka shkelur LPP ose RrPP gjatë procedurës së prokurimit publik, atëherë keni të drejtë të filloni një procedurë rishikimi siç parashikohet në Kreun VII të LPP-së.

Edhe pse nuk mundëm të përdornim shërbimet tuaja në këtë rast, besoj se do të vazhdoni të jeni i interesuar në nismat tona të prokurimit.

Me respekt  
< **Emri** >

Dokumenta Standarde të Tenderit  
**Rikonstruksioni i Magjistralit Kryesor dhe Rrjetit të Brendshëm të Ujësjellësit Qytetit Patos Loti II”.**

**Shtojca 16**

[ Shtojcë për t’u plotësuar Autoriteti Kontraktor]

**FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT**

[Data \_\_\_\_\_]

Për: [Emri dhe adresa e ofertuesit të shpallur fitues]

Procedura e prokurimit:

Numri i referencës së procedurës/lotit:

Përshkrim i shkurtër i kontratës: [Sasia ose qëllimi dhe kohëzgjatja e kontratës]

Publikime të mëparshme (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: çmimi më i ulët oferta ekonomikisht më e favorshme

Njoftojme se, kane qenë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:

1. \_\_\_\_\_  
*Emri i plotë i shoqërisë* *numri i NIPT-it*

Vlera \_\_\_\_\_  
*(me numra dhe fjalë)*

2. \_\_\_\_\_  
*Emri i plotë i shoqërisë* *numri i NIPT-it*

Vlera \_\_\_\_\_  
*(me numra dhe fjalë)*

Etj. \_\_\_\_\_

Janë skualifikuar ofertuesit e mëposhtëm:

1. \_\_\_\_\_  
*Emri i plotë i shoqërisë* *numri i NIPT-it*

2. \_\_\_\_\_  
*Emri i plotë i shoqërisë* *numri i NIPT-it*

Përkatësisht për arsyet e mëposhtme:

\_\_\_\_\_  
\_\_\_\_\_  
\_\_\_\_\_

\* \* \*

**Rikonstruksioni i Magjistralit Kryesor dhe Rrjetit të Brendshëm të Ujësjellësit Qytetit Patos Loti II”.**

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë [*emri dhe adresa e ofertuesit të shpallur fitues*] se oferta e paraqitur, me një vlerë të përgjithshme prej [*shuma përkatëse e shprehur në fjalë dhe shifra*]/pikët totale të marra [\_\_\_\_\_] është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë [*emri dhe adresa e autoritetit kontraktor dhe referenca e kontaktit*] sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda \_\_\_\_\_ ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të konfiskohet sigurimi i ofertës suaj (nëse është kërkuar) dhe kontrata do t’i akordohet ofertuesit vijues në klasifikimin përfundimtar, oferta e të cilit është dorëzuar me një vlerë të përgjithshme prej [*vlera përkatëse e shprehur në fjalë dhe shifra*], siç parashikohet në nenin 58 të Ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë \_\_\_\_\_

Ankesa: ka ose jo \_\_\_\_\_

(nëse ka) ka marrë përgjigje në datë \_\_\_\_\_

[Titullari i autoritetit kontraktor]

Dokumenta Standarde të Tenderit  
**Rikonstruksioni i Magjistralit Kryesor dhe Rrjetit të Brendshëm të Ujësjellësit Qytetit Patos Loti II”.**

**Shtojca 17**

[ *Shtojcë për t’u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor në rastin e marrëveshjes kuadër* ]

**FORMULARI I NJOFTIMIT TË OPERATORËVE EKONOMIKË TË SUKSESSHËM NË MARRËVESHJEN KUADËR**

[Data]

Për: *[Emri dhe adresa e operatorëve ekonomikë të shpallur fitues]*

1. \_\_\_\_\_
2. \_\_\_\_\_
3. \_\_\_\_\_

\* \* \*

Procedura e prokurimit: \_\_\_\_\_

Numri i referencës së procedurës/lotit:

Përshkrim i shkurtër i kontratës: *[Sasia, objekti , kohëzgjatja e kontratës etj]*

Publikime të mëparshme (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: oferta ekonomikisht më e favorshme çmimi më i ulët

Njoftojmë se, kanë qenë pjesëmarrës në procedurë këta operatorë ekonomikë, me shumatorën e çmimeve për njësi të ofruar/ me vlerat përkatëse të ofruara:

1. _____	_____
<i>Emri i plotë i shoqërisë</i>	<i>numri i NIPT-it</i>

Shumatorja e çmimeve për njësi të ofruar/vlera _____	_____
	<i>(me numra dhe fjalë)</i>

2. _____	_____
<i>Emri i plotë i shoqërisë</i>	<i>numri i NIPT-it</i>

Shumatorja e çmimeve për njësi të ofruar/vlera _____	_____
	<i>(me numra dhe fjalë)</i>

Etj. \_\_\_\_\_



Dokumenta Standarde të Tenderit

**Rikonstrukcioni i Magjistralit Kryesor dhe Rrjetit të Brendshëm të Ujësjellësit Qytetit Patos Loti II”.**

Janë skualifikuar operatorët ekonomikë të mëposhëm:

1. \_\_\_\_\_  
*Emri i plotë i shoqërisë* *numri i NIPT-it*
2. \_\_\_\_\_  
*Emri i plotë i shoqërisë* *numri i NIPT-it*

Perkatësisht për arsyet e mëposhtme:

\_\_\_\_\_  
\_\_\_\_\_  
\_\_\_\_\_

\* \* \*

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë se janë identifikuar si operatorë ekonomikë të suksesshëm:

1. \_\_\_\_\_  
*Emri i plotë i shoqërisë* *numri i NIPT-it*

Shumatorja e çmimeve për njësi të ofruar/Vlera \_\_\_\_\_/Pikët totale të marra \_\_\_\_\_  
(me numra dhe fjalë)

2. \_\_\_\_\_  
*Emri i plotë i shoqërisë* *numri i NIPT-it*

Shumatorja e çmimeve për njësi të ofruar/Vlera \_\_\_\_\_/Pikët totale të marra \_\_\_\_\_  
(me numra dhe fjalë)

Etj. \_\_

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqiteni pranë [emri dhe adresa e autoritetit kontraktor dhe referenca e kontaktit], brenda \_\_\_\_\_ ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi për të lidhur draft marrëveshjen.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë \_\_\_\_\_

Ankesa: ka ose jo \_\_\_\_\_  
(nëse ka) ka marrë përgjigje në datë \_\_\_\_\_

Dokumenta Standarde të Tenderit

**Rikonstruksioni i Magjistralit Kryesor dhe Rrjetit të Brendshëm të Ujësjellësit Qytetit Patos Loti II”.**

[Titullari i autoritetit kontraktor]

**Shtojca 18**

**KUSHTET E PËRGJITHSHME TË KONTRATËS**  
**Punët – Procedura e Hapur**

**Neni 1: Qëllimi**

- 1.1 Këto kushte të përgjithshme të kontratës (KPK) do të zbatohen për kryerjen e Punëve të prokuruarra ne bazë të legjislacionit të prokurimit.
- 1.2 Ligji për Prokurimin Publik në Republikën e Shqipërise parashikon se dispozitat e Kodit Civil Shqiptar do të zbatohen për kontratat e prokurimit publik. Disa dispozita të Kodit Civil janë rishprehur në KPK me qëllim që të rrisin transparencën e kushteve të kontratës. Megjithatë, citimi i disa dispozitave këtu nuk mohon në asnjë mënyrë zbatimin e dispozitave të tjera të Kodit Civil të kësaj kontrate.
- 1.3 Në mënyrë të ngjashme, disa dispozita të Ligjit mbi Prokurimin Publik janë rishprehur në KPK me qëllim që të rrisin transparencën e ligjit që rregullon prokurimin publik. Megjithatë, citimi i disa dispozitave këtu nuk mohon në asnjë mënyrë zbatimin e dispozitave të tjera të Ligjit mbi Prokurimin Publik mbi të drejtat, detyrat dhe detyrimet e palëve.
- 1.4 KPK do të zbatohen deri në atë masë që të mos lënë mënjanë kushtet ose dispozitat e parashikuara në pjesë të tjera të kontratës.
- 1.5 Kushtet e kontratës përfshijnë gjithashtu Kushtet e Veçanta të Kontratës (KVK). Në rast se ka një konflikt midis KPK dhe KVK, KVK do të mbizotërojnë mbi KPK.

**Neni 2: Përkufizime**

- 2.1 “Preventiv total” do të thotë volumet e punes te dhena ne projekt te cilat jane orientuese, plotesuar me cmimin total të përcaktuar që është pjesë e Ofertes në një kontratë me çelsa ne dore.
- 2.2 “Preventiv per njesi” do të thotë volumet e punes te dhena ne projekt shoqeruar me cmimet per njesi te pandryshuara që janë pjesë e Ofertes në një kontratë me punime ne matje.
- 2.3 “Afati i realizimit te punimeve” do të thotë data që Punët duhet të perfundojnë siç është shprehur në Grafikun për realizimin Punimeve , e vertetuar nga enti prokures.
- 2.4 “Kontratë” do të thotë marrëveshja e shkruar e lidhur midis Autoritetit Kontraktor dhe kontraktorit që përbëhet nga dokumentat e tenderit duke përfshirë KPK dhe KVK, të gjitha bashkangjitet dhe formularët e plotësuar dhe të gjitha dokumentat e tjera që përfshihen në referimin e çdo dokumenti.
- 2.5 “Cmim kontrate” do të thotë çmimi që i paguhet kontraktorit sipas kontratës për zbatimin e

**Rikonstruksioni i Magjistralit Kryesor dhe Rrjetit të Brendshëm të Ujësjellësit Qytetit Patos Loti II”.**

- plotë dhe të përpiktë të detyrimeve të tij kontaktore.
- 2.6 “Realizimi i punimeve” do të thotë data e vërtetuar nga Autoriteti Kontraktor se Punët janë mbaruar.
- 2.7 “Defekt” do të thotë çdo pjesë e Punimeve e paperfunduar në përputhje me kontratën.
- 2.8 “Data e hyrjes” do të thotë data që Autoriteti Kontraktor lejon kontraktorin në kantier.
- 2.9 “Data e fillimit” është përfshirë në Të dhënat e kontrates. Ajo është data kur kontraktori do të fillojë punimet e ndertimit. Në se kjo nuk realizohet, “data e fillimit “do të jete dita në të cilën do të paguhet paradhënia.
- 2.10 “Pajisje” do të thotë makineritë dhe veglat e kontraktorit të sjella përkohësisht në kantier për realizimin e Ndertimeve.
- 2.11 “Materiale” do të thotë të gjitha furnizimet, duke përfshirë ato të konsumit, të përdorura nga kontraktori për kryerjen e punimeve.
- 2.12 “Objekt i kontratës” do të thotë të gjitha Punët që kontraktori do të sigurojë sipas kushteve të kontratës.
- 2.13 “Palë(t)” do të thotë nënshkruesit e kontratës.
- 2.14 “Drejtues projekti” do të thotë personi i emëruar nga Autoriteti Kontraktor që është përgjegjës për administrimin e kontratës për Autoritetin Kontraktor.
- 2.15 “Autoritet Kontraktor” do të thotë Autoriteti Kontraktor që është pjesë e kësaj kontrate dhe që kontraktori punët objekt i kësaj kontrate. Ky term kudo që përdoret ka kuptim të njëjtë me atë të perkufizuar në ligj.
- 2.16 “Kantier” do të thotë vendi fizik i Punimeve.
- 2.17 “Raport i inspektimit të kantierit” do të thotë dokumentat e përfshira në dokumentat e tenderit që pasqyrojnë informacion faktik dhe të interpretuar rreth kushteve të sipërfaqes dhe nëntokës së kantierit.
- 2.18 “Nënkontraktues” do të thotë çdo person fizik ose ligjor ose kombinim i mësipërm, që furnizon Punët, materialet ose pajisjet për ose në emër të kontraktorit.
- 2.19 “Kontraktor” do të thotë personi fizik ose juridik që është palë e kësaj kontrate dhe sipas dispozitave të kësaj kontrate siguron Punimet.
- 2.20 “Standarte Teknike” do të thotë specifikimet e aprovuara nga një trup i posaçëm standartizimi për zbatimin e vazhdueshëm ose të përsëritur. Standarte të tilla përdoren si rregulla, rregullore ose perkufizim të karakteristikave për të siguruar se materialet dhe shërbimet e procesuara i përgjigjen qëllimit.

**Rikonstruksioni i Magjistratit Kryesor dhe Rrjetit të Brendshëm të Ujësjellësit Qytetit Patos Loti II”.**

- 2.21 “Ngritja e kantierit” do të thotë punimet e ndertimit të përkohshme, të ndërtuara e instaluar, që janë të nevojshme për zbatimin e punimeve të ndërtimit.
- 2.22 “Punime” do të thotë ajo që Autoriteti Kontraktor i kërkon nga kontraktori të gërmojë, ndërtojë, riparojë, rinovojë ose instalojë siç parashikohet në dokumentat e tenderit duke përfshirë shërbimet në lidhje me to, gjithashtu të përkufizuara në dokumentat e tenderit.

**Neni 3: Hartimi i Kontratës**

- 3.1 Njoftimi i ofertes fituese do të shërbejë për hartimin e kontratës midis palëve, e cila duhet të firmoset brenda afatit të shprehur në dokumentat e tenderit.
- 3.2 Ekzistenca e kontratës do të konfirmohet me nënshkrimin e dokumentit të kontratës duke sanksionuar të gjitha marrveshjet midis palëve.

**Neni 4: Praktikrat e Korrupuara, Konflikti i Interesit dhe Kontrolli i Procesverbaleve**

- 4.1 Autoriteti Kontraktor mund t’i kërkojë gjykatës të deklarojë të paligjshme kontratën nëse zbulon se kontraktori ka kryer veprime të korrupuara. Veprimet e korrupuara përfshijnë veprimet e përshkruara në Nenin 26 të Ligjit mbi Prokurimin Publik.
- 4.2 Kontraktori nuk duhet të ketë lidhje (të tashme ose të shkuara) me asnjë konsulent ose ent që ka marrë pjesë në përgatitjen e dokumentave të tenderit për këtë prokurim.
- 4.3 Kontraktori duhet të lejojë Autoritetin Kontraktor të inspektojë llogaritë dhe regjistrat që kanë lidhje me zbatimin e kontratës ose t’i kontrollojë ato me anë të kontrollorëve të emëruar nga Autoriteti Kontraktor.

**Neni 5: Informacioni Konfidencial**

- 5.1 Kontraktori dhe Autoriteti Kontraktues duhet të mbajnë në konfidencë të gjitha dokumentat, të dhënat dhe informacionet e tjera të dhëna nga pala tjetër në lidhje me kontratën.
- 5.2 Kontraktori mund t’i japë nënkontraktorit dokumenta të tilla, të dhëna ose informacione të tjera që merr nga Autoriteti Kontraktor deri në masën e kërkuar që nënkontraktorin të zbatojë punën e tij sipas kontratës. Në rast të tillë, kontraktori duhet të përfshijë në kontratën e tij me nënkontraktorin një dispozitë që premtion ruajtjen e konfidencës siç thuhet në Paragrafin 5.1 më sipër.

**Neni 6: Prona Intellektuale**

- 6.1 Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në kontratë, të gjitha të drejtat e pronës intelektuale të siguruara nga kontraktori gjatë zbatimit të kontratës do t’i përkasin Autoritetit Kontraktor i cili mund t’i përdorë ato sipas gjykimit të tij.
- 6.2 Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në kontratë, kontraktori, pas përfundimit të kontratës, duhet t’i dorëzojë Autoritetit Kontraktor të gjitha raportet dhe të dhënat si

**Rikonstruksioni i Magjistralit Kryesor dhe Rrjetit të Brendshëm të Ujësjellësit Qytetit Patos Loti II”.**

hartat, diagramët, skicimet, specifikimet, planet, statistikat, llogaritjet dhe regjistrat mbështetës ose materialet e fituara, mbledhura ose pregatitura nga kontraktori gjatë zbatimit të kontratës. Kontraktori mund të mbajë kopje të këtyre dokumentave dhe të dhënave, po nuk duhet t’i përdori për qëllime që s’kanë lidhje me kontratën pa leje paraprake me shkrim nga Autoriteti Kontraktor.

- 6.3 Kontraktori duhet të garantojë Autoritetin Kontraktor zhveshjen nga përgjegjësia për shkelje të drejtave të pronës intelektuale, që mund të dalin nga përdorimi i materialeve, skicave ose çdo prone tjetër sipas kontratës.
- 6.4 Në rast se ngrihet ndonjë pretendim ose padi kundër Autoritetit Kontraktor në lidhje me ndonjë shkelje të pronës intelektuale të shkaktuar nga zbatimi i kontratës ose nga përdorimi i materialeve, skicave ose çdo prone tjetër të mbrojtur e të furnizuar sipas kontratës, kontraktori duhet t’i japë Autoritetit Kontraktor të gjitha provat dhe informacionin në posedim të kontraktorit që kanë të bëjnë me këtë padi apo pretendim.

**Neni 7: Origjina e Materialeve**

- 7.1 Nuk ka asnjë kufizim për kombësinë e origjinës së materialeve, përveç atyre që mund të jenë përcaktuar në ndonjë Rezolutë të Asamblesë së Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara.
- 7.2 Kontraktori mund të jetë i detyruar të verifikojë origjinën e materialeve.
- 7.3 Për qëllime verifikimi “origjinë” do të thotë vendi ku materialet janë nxjerrë, bashkuar ose prodhuar. materialet janë prodhuar kur, nëpërmjet prodhimit, procesimit, ose mbledhjes së mjaftueshme të komponentëve, rezulton një produkt i ri i njohur në tregti që është mjaft i ndryshëm në karakteristikat bazë ose në qëllim apo përdorim nga komponentët e tij.
- 7.4 Origjina e materialeve ka dallim nga kombësia e kontraktorit ose nënkontraktorit që furnizon me materiale.

**Neni 8: Vendimet e Drejtuesit të Projektit**

- 8.1 Drejtuesi i projektit do të vendosë për çështjet e kontratës midis kontraktorit dhe Autoritetit Kontraktor
- 8.2 Drejtuesi i Projektit mund të delegojë ndonjë nga detyrat dhe përgjegjësitë e tij tek të tjerët përveç zgjidhjen e mosmarrveshjeve dhe konflikteve. Drejtuesi i projektit duhet të njoftojë kontraktorin për delegimet e bëra apo të revokuara.

**Neni 9: Komunikimi**

- 9.1 Çdo komunikim midis palëve duhet të bëhet me shkrim.

**Neni 10: Bashkëpunimi në Kantier me të Tjerët**

- 10.1 Kontraktori duhet të bashkëpunojë dhe të ndajë kantierin me firma të tjera, autoritete

**Rikonstruksioni i Magjistralit Kryesor dhe Rrjetit të Brendshëm të Ujësjellësit Qytetit Patos Loti II”.**

publike, shërbimet publike dhe Autoritetin Kontraktor siç kërkohet dhe përkufizohet në Grafikun e realizimit të punimeve.

**Neni 11: Përgjegjësia e Autoritetit Kontraktor**

11.1 Autoriteti Kontraktor ka përgjegjësi të kompensojë kontraktorin për dëmtime të pajisjeve të kontraktorit deri në masën që lidhet me veprime me faj të Autoritetit Kontraktor ose të projekteve të Autoritetit Kontraktor me përjashtim të rastit kur keto të fundit, kishin gabime të dukshme që mund të ishin konstatuar lehtësisht nga kontraktuesi.

**Neni 12: Raporti i Inspektimit të Kantierit dhe Kushtet e Kantierit**

12.1 Autoriteti Kontraktor nuk mban asnjë përgjegjësi për konkluzionet ose interpretimet e bëra në raportin e inspektimit të kantierit.

12.2 Kontraktori pranon se i ka marrë të gjitha hapat e nevojshme për të verifikuar natyrën dhe vendin e Punimeve dhe se ka inspektuar dhe pajtohet me kushtet e përgjithshme dhe lokale që mund të ndikojnë në kryerjen ose koston e Punëve.

**Neni 13: Kontraktori që Kryen Punimet**

13.1 Kontraktori duhet të kryejë dhe mbarojë Punimet në përputhje me specifikimet teknike të paraqitura në dokumentat e tenderit.

